Në mbështetje të nenit 3.1, nenit 6 (paragrafët 6.3, 6.6 dhe 6.7), nenit 7 (paragrafët 7.1.2 dhe 7.6.1), nenit 9 dhe nenit 11.2 të Rregullores për Procedurën dhe Masat Disiplinore të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), Komisioni Disiplinor i FVK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqyrtimit të provave, mori këtë:

V E N D I M

I. Astrit Shala, në cilësinë e trajnerit të KV Skënderbeu, shpallet përgjegjës për shkelje disiplinore, të manifestuar përmes sjelljes josportive dhe ofenduese ndaj gjyqtarëve të ndeshjes KV Skënderbeu – KV Ulpiana, të zhvilluar më 11.10.2026 në Lipjan.

II. Astrit Shalës i shqiptohet gjobë financiare në shumën prej 500,00 (pesëqind) eurosh.

III. Astrit Shalës i shqiptohet masa disiplinore e ndalimit të ushtrimit të funksionit të trajnerit për tri (3) ndeshje zyrtare, duke filluar nga ndeshja e parë zyrtare pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, sipas kalendarit të garave dhe dispozitave të zbatueshme.

IV. Rikthimi i trajnerit Astrit Shala në ushtrimin e funksionit të tij zyrtar, pas përfundimit të masës së ndalimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, kushtëzohet me shlyerjen e plotë të gjobës financiare të shqiptuar sipas pikës 2, si dhe me dorëzimin e dëshmisë së pagesës pranë organeve kompetente të Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK).

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Pas pranimit të vendimit për inicimin e procedurës disiplinore, të datës 12.10.2026, dhe dokumentacionit përkatës lidhur me ndeshjen KV Skënderbeu – KV Ulpiana, të zhvilluar më 11.10.2026, Komisioni Disiplinor i FVK-së ka mbajtur mbledhje në përbërje të plotë më datë 13.10.2026 dhe më datë 16.10.2026. Komisioni ka administruar raportin e delegatit, deklaratat e gjyqtarëve dhe deklaratën me shkrim të trajnerit Astrit Shala, si dhe ka vlerësuar rrethanat e rastit dhe historikun disiplinor të tij.

Nga raportet rezulton se trajneri është ndëshkuar me karton të verdhë gjatë ndeshjes për sjellje të papërshtatshme. Pas përfundimit të ndeshjes janë raportuar fyerje ndaj gjyqtarëve. Delegati ka raportuar edhe kërcënim verbal ndaj gjyqtarit të dytë; gjyqtari i parë ka sqaruar se nuk ka pasur tentim për sulm fizik. Pretendimi për kërcënim verbal vlerësohet veçmas nga konstatimi për sjellje ofenduese dhe nuk barazohet me sulm fizik.

Në deklaratën e tij, Astrit Shala pranon se reagimi ka qenë i papërshtatshëm, kërkon falje dhe shpreh keqardhje. Komisioni e vlerëson këtë qëndrim si rrethanë lehtësuese, por deklarata nuk përmban pranim të shprehur të kërcënimit të raportuar.

Në përcaktimin e masës disiplinore, Komisioni ka marrë parasysh si rrethanë rënduese historikun e mëparshëm disiplinor të trajnerit, përfshirë faktin se ai ka qenë i ndëshkuar më parë me ndalim gjashtëmujor të ushtrimit të funksioneve dhe aktivitetit sportiv. Si rrethanë lehtësuese është vlerësuar kërkimfalja me shkrim, pranimi i reagimit të papërshtatshëm dhe shprehja e keqardhjes. Komisioni ka peshuar këto rrethana në raport me rëndësinë e sjelljes së konstatuar.

P Ë R F U N D I M

Duke peshuar rëndësinë e sjelljes së konstatuar, mbrojtjen e autoritetit të gjyqtarëve, historikun disiplinor dhe kërkimfaljen, Komisioni vlerësoi se masat e shqiptuara janë të nevojshme për parandalimin e shkeljeve të ngjashme dhe vendosi si në dispozitiv.

KOMISIONI DISIPLINOR

Gani Beqiri, anëtar	Fidan Hamiti, kryetar	Liridon Dalipi, anëtar

Vendimi t'u dërgohet:

1. Astrit Shalës;
2. KV Skënderbeu;
3. Komesarit të Garave;
4. Zyrtarëve të ndeshjes;
5. Arkivit të FVK-së.

KËSHILLË JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 12.1 të Rregullores Disiplinore, kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në Komisionin e Ankesave të FVK-së brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, kundrejt pagesës së tarifës së ankesës prej 300,00 eurosh, sipas rregullores.